




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac

Vendi I takimit	Hapësirat e Kuvendit komunal në Klokot
Datë	25.04.2019

Në bazë të nenit 52, pika 52.1.dhe 52.2 Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe Statuti i Komunës nga Neni 26, pika 26.1 dhe 26.2.Në ambientet e Kuvendit të Klokotit u mbajt seanca e katërt e rregullt e Komisionit për Politikë dhe Financa të Komunës së Klokotit për vitin 2019. Me rastin e mëposhtëm,

PROCESVERBALI NGA SENACA E KATËRT E RREGULLT E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Seancën e udhëheqi kryesuesi I komitetit për politikë dhe financa z.Zarko Dejanovic.

Në fillim kryesuesi I përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë.

Pas thirrjes u vërtetua se ekziston kuorum për punën e seancës.

Anëtarët prezent 5

Në fillim të seancës kryesuesi lexoi rendin e ditës I cili përbëhej prej 6 pikave.

1. Aprovimi i procesverbalit nga seanca e tretë e rregullt e Kuvendit komunal nga viti 2019;
2. Informimi i Inspektorit të Tregut;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit të Kuvendit për përdorimin e shpenzimeve të mbushjeve të operatorit mobil „IPKO,,;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit tremujor financiar nga viti 2019;
5. Propozim vendimi për dhënjen e autorizimit dhe nismës së kryetarit të komunës së Klokotit për nnisjen e bashkëpunimit ndërkomunal me komunën e Vitisë në fushën e infrastrukturës rrugore.
6. Të ndryshme

Kryesuesi Zarko Dejanovic: Kush është për aprovimin e rendit të ditës së sotme?

Konstatohet që nënjëzërit e kemi aprovuar rendin e ditës së sotme me 5 vota për.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës e ajo është :

1. Aprovimi i procesverbalit nga seanca e tretë e rregullt e Kuvendit komunal nga viti 2019;

A dëshiron dikush të thotë dicka lidhur me procesverbalin? Pasi që askush nuk dëshiron të thotë dicka po e jap në aprovim. Kush është për aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës?

Konstatohet që me 5 vota për aprova pikën e parë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës e ajo është :

2. Informimi i Inspektorit të Tregut;

Të nderuar delegatë, Inspektori i Tregut do të jetë prezent në seancën e kuvendit pastaj do ta sqarojë këtë pikë. Kjo pikë ka qenë në seancën e kaluar në rend të ditës, por për arsye të justifikueshme nuk ka qenë e pranishme në seancë.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit të Kuvendit për përdorimin e shpenzimeve të mbushjeve të operatorit mobil „IPKO“;

Ju e keni marrë materialin Kryetari ka marrë vendim që delegatët dhe të gjithë funksionerët të lidhen në rrjet dhe të marrin mbushje dhe numra të telefonit dhe të komunikojnë në mes vete.

Delegati Petkovic: Nëse është propozimi më i mirë, operatori më i favorshëm, unë jam gati ta miratoj atë. Por pse nuk ka operatorë të tjerë?

Kryesuesi : Për shkak se IPKO është më i favorshmi. Ne deri më tani nuk kemi mundur të shfrytëzojmë sepse kemi patur borxhin që e ka shfrytëzuar qeverisja e kaluar. Kush është për aprovimin e kësaj pike?

Konstatohet që njëzërit e aprova pikën e tretë të rendit të ditës.

4. dhe aprovimi i raportit tremujor financiar nga viti 2019;

Unë kam biseduar me Zotëriun Kelmend zyrtarin për financa ai në Kuvend do ta sqarojë më detajisht këtë pikë. Po e jap në votim këtë pikë.

Konstatohet se njëzërit u aprova pika e katërt e rendit të ditës.

5. Propozim vendimi për dhënjen e autorizimit dhe nismës së kryetarit të komunës së Klllokotit për nnisjen e bashkëpunimit ndërkomunal me komunën e Vitisë në fushën e infrastrukturës rrugore.

Të nderuar delegatë Unë isha në një takim para një jave me drejtorin e kadastrës dhe jam i njohur me këtë propozim, ku do të nënshkruhet Memorandumi për bashkëpunim midis dy komunave, është një

projekt prej 150 deri 300 mijë euro, ku të gjitha komunat mund të aplikojnë. Ne kemi përparësi për të aplikuar sepse Vitina është më e madhe dhe ne mund të ndërtojmë trotuar prej Klllokot deri në Viti, Mogillë –Viti dhe Klllokot-Pozheran. Do të ketë edhe ndricim rrugor.

Kush është për aprovimin e kësaj pike?

Konstatohet që njëzërit e aprovuam pikën e pestë të rendit të ditës.

6. Të ndryshme;

Pasi që askush nuk u paraqit për fjalë po e mbyll seancën e katërt të komitetit për politikë dhe financa.

Datë: 25.04.2018

Kryesuesi I kuvendit komunal Klllokot-Vërbovc



/Zarko Dejanovic/